



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 451-14230/2024

Klinë, më 25/09/2024

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, botuar në gazetën zyrtare, nr 28 më dt.04.06.2008, nenin 91 paragrafi 1 i Statutit të Komunës së Klinës të dt.07.04.2010, nenin 2 pika 2.3 dhe nenit 4 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nr.03/L-49, si dhe duke marrë parasysh kërkesën e Shoqatës Sindikale të QKMF-së të datës 03.04.2024, Kryetari i Komunës së Klinës, **mori**;

V E N D I M

1. **LEJOHËT**, ndarja e mjeteve financiare në shumën prej **950.00 €** (nëntëqind e pesëdhjetë euro) për Shoqatën Sindikale të QKMF-së në Klinë. Mjetet ndahen më qellim të realizimit të vizitës tre ditore në Shqipëri të punëtorëve shëndetësorë të QKMF-së në Klinë për nder të 1 majit, sipas kërkeses së datës 03.04.2024. Mjetet në shumën deri **950.00 €** paguhen nga subvencionet e zyrës së kryetarit.
2. Mjetet si nga pika 1 e këtij vendimi derdhen në xhironlogarinë e Shoqatës Sindikale të QKMF-së në Klinë të cilës i dedikohen.
3. Obligohet, përfaqësuesi i Shoqatës Sindikale, që për mjetet e ndara në shumën e lartcekur Komunës së Klinës, t'ia paraqes raportin zyrtar të shpenzimeve.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, në bashkëpunim më Zyrën e Kryetarit.
5. Ky vendim është i plotëfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Të njoftohen:

- Shoqata Sindikale QKMF Klinë;
- DFEZH;
- DSHMS;
- Arkivi.

Kryetari

Zenun Elezaj

